



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.06.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Flutura Aça – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbalit të datës 16 maj 2022.
- Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 30 maj-17 qershor 2022.

Marrin pjesë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Desantila Tahiraj, Meri Markiçi, Luçiano Boçi , Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Baku, Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Agron Gjekmarkaj, Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake.

HAPET MBLEDHJA

Flutura Aça - Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Ju uroj një javë të mbarë të gjithëve!

Sot do të zhvillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, datë 6 qershor 2022. Besoj se ju të gjithë jeni njohur me rendin e ditës.

Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbalit të datës 16 maj 2022. Besoj se e keni lexuar. A keni ndonjë vërejtje, apo ndonjë gjë të paqartë që doni ta referoni? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me procesverbalin e datës 16 maj 2022?

Të gjithë dakord.

Miratohet.

Si pikë të dytë kemi diskutimin dhe miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 30 maj -17 qershor 2022. Edhe me këtë pikë besoj se të gjithë jeni njohur. Ka një propozim që mbledhjet e datave 7 dhe 8 të bëhen në datën 8, pra, kjo do të thotë që në datën 8 do të bëjmë dy mbledhje, në orën 10:00 do të bëjmë mbledhjen e parë për diskutimin e projektrezolutës dhe në mbledhjen tjetër do të zhvillojmë seancën dëgjimore me kandidatët për 2 vendet vakante për Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Nëse jeni dakord do t'i bëjmë këto dy mbledhje ditën e mërkurë në orën 10:00. Stafii do të kujdeset për këtë gjë.

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Ne do ta lëmë datën 8 siç është, por mbledhjen e ditës së nesërme propozojmë ta bëjmë pasnesër, në orën 10:00.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, mbledhjen e datës së nesërme do ta bëjmë të mërkurën në orën 10:00 dhe më pas do të bëjmë mbledhjen tjetër në orën 11:00.

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Koçi!

A jeni dakord që të bëjmë dy mbledhje ditën e mërkurë, në orën 10:00 mbledhjen e parë dhe në orën 11:00 seancën dëgjimore? Dakord.

Në sekretari janë depozituar edhe CV-të e kandidaturave. Nëse ndonjëri prej jush është i interesuar paraprakisht për CV-të, i ka në sekretari, mund t'i shfletojë, ndërsa pjesën tjetër do ta

diskutojmë gjatë seancës dëgjimore. Në fakt, pjesa e përzgjedhjes së kandidaturave do të jetë me dyer të mbyllura, ndërsa pjesa e parë do të jetë publike.

Për periudhën që folëm në kalendar janë edhe dy pika të tjera.

E para, ka të bëjë me projektvendimin për një ndryshim në vendimin nr. 36/2022 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”. Do të vendosim datën se kur mendoni ta diskutojmë.

E dyta, ka të bëjë me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Sa i takon këtij projektligji është propozim i deputetes Ina Zhupa, ndërsa komision për dhënie mendimi është Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Unë sugjeroj, në mirëkuptimin dhe dëshirën e anëtarëve të komisionit, që projektvendimin, duke qenë se është i pari në listë, ta lëmë për ditën e hënë, ndërsa projektligjin ditën e martë ose mund të ecim me metodën 2 mbledhje në një ditë, varet se si e mendoni ju.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë sugjeroj t’i bëjmë të dyja mbledhjet ditën e martë, sepse i pari është projektvendim për një ndryshim në vendimin nr. 36/2022, dhe në orën 11:30 të diskutojmë projektligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Zhupa!

Zoti Koçi, keni ndonjë propozim tjetër?

Petro Koçi – Unë jam dakord që të dyja mbledhjet t’i lëmë për javën që vjen.

Lidhur me përcaktimin e ditës, pra të hënë, të martë apo të mërkurë ta lëmë të hapur, pra ta vendosim në vijim. A më dëgjoni, zonja Zhupa?

Pra, të biem në parim dakord që të dyja mbledhjet t’i bëjmë javën e ardhshme, duke shfrytëzuar të tria ditët: të hënë, të martë dhe të mërkurë, ndërsa sa i takon përcaktimit të ditës dhe orarit, ta lëmë të hapur ta vendosim ne, si kryesi, në kombinim me të gjithë ju dhe me mbledhjet e tjera të komisioneve.

Unë kam sugjerim për çështjen e projektrezolutës. Ne kemi një projekt, për ta bërë si radhën e parë që të arrijmë në një produkt konsensual, ju lutem, deri ditën e mërkurë kush ka propozime t’i dërgojë, në mënyrë që të përpunohen dhe të bien dakord propozuesit dhe ne që e

drejtojmë komisionin, në mënyrë që të mos e zgjasim më, pasi si debat e kemi konsumuar, sepse është bërë goxha debat thelbësor ditën që kemi bërë dëgjesën. Kjo ishte ajo që unë doja t'ju propozoja, për të pasur më shumë produktivitet në mbledhjen e ditës së mërkurë.

Faleminderit!

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Koçi!

Atëherë, t'i lëmë të hapura të dyja mbledhjet që kemi për javën e ardhshme.

Me aq sa unë di dy deputetët, zoti Boçi dhe zonja Zhupa, kanë shtesa në lidhje me projektrezolutën, por unë besoj që ne do t'i kemi konsumuar deri ditën e mërkurë, pra edhe që komisioni të njihet dhe, më pas, të vendosim se si do t'i bëjmë përmirësimet e nevojshme.

Po ashtu, kam edhe një çështje që dua ta diskutoj me ju, çështja e vajzës së dhunuar në Librazhd, një çështje që më ka tronditur shumë dhe mendoj se do të ishte shumë e nevojshme një seancë dëgjimore me AMA-n, çfarë nevojash mund të kenë ata prej nesh, pasi akti ishte me vonesë. Gjërat ndodhën me një shpejtësi të llahtarshme, por ligji dhe AMA duhet të veprojnë shumë më shpejt sesa veprojnë keqbërësit në Shqipëri. Unë propozoj ekskluzivisht një seancë dëgjimore, duke marrë shkas nga ngjarja, në mënyrë që të parandalojmë ngjarje të tjera të kësaj natyre, sepse janë me mijëra vajza, të cilat mund të kenë nevojë për mbështetjen tonë.

Ju e dini, por mendoj se këtë gjë duhet ta vendosim bashkë, unë për vete e kam përjetuar shumë keq, madje disa ditë nuk kam qenë mirë, sepse ka qenë një ngjarje në kufijtë e mesjetës dhe të inkuizicionit.

Faleminderit!

Petro Koçi – Edhe unë i bashkohem shqetësimit të kryetares. Besoj se ky ka qenë një shqetësim që e kemi ndjerë të gjithë. Transmetimi në portale dhe në media me të vërtetë është një ngjarje shumë e rëndë. Sigurisht që ne nuk u hyjmë çështjeve private të individëve të caktuar, por ajo që ka ndodhur ka qenë me të vërtetë një linçim publik i një shtetaseje që ka të drejtat e veta, madje edhe për të gabuar, në fund të fundit, por që ky linçim nuk mund të lejohet, sepse ka qenë vërtetë barbarizëm, një kthim prapa dhe që nuk ka lidhje me kohën e civilizimit të sotëm.

Unë do t'ju propozoja që një grup prej nesh me përfaqësim të barabartë të bëjmë një takim me kryetaren e AMA-s pa bërë dëgjesë, sepse dëgjesa do të kërkonte kohë, do të kishte biseda të gjata, të cilat do të publikohen, prandaj mendoj të mos e ngacmojmë më tej këtë dukuri. Mendimi im është të bëjmë një takim me kryetaren e AMA-s.

Jam dakord me atë që ju thatë, zonja kryetare, që reagimi duhej të ishte më i shpejtë, pra që në momentin e parë që shfaqen imazhet, reagimi duhet të jetë më i shpejtë.

Unë mendoj që ne, si drejtues komisioni, dy deputetë nga opozita dhe dy nga maxhoranca të bëjmë një takim jo vetëm me drejtuesen e AMA-s, por me të gjithë ata që janë atje dhe ta bëjmë publik këtë takim. Pra, të bëjmë një komunikatë të përbashkët që ne bëjmë një takim, kërkuam këtë apo atë dhe besoj se kjo do të mjaftojë.

Flutura Açka – Unë mendoj që deri ditën e premte ne mund ta bëjmë këtë takim, mund ta bëjmë edhe këtu në komision, ta vendosim bashkë se kush do të jenë përfaqësuesit, kjo nuk ka rëndësi, sepse kushdo prej nesh përfaqëson komisionin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, mund ta bëjmë edhe nesër. Do të përpiqemi ta zgjidhim me stafin këtë punë, sepse kjo është një gjë është mjaft e rëndësishme.

Po, zoti Ndreca.

Eduard Ndreca – Faleminderit, kryetare!

Unë e çmoj shumë të arsyeshme atë që ju thatë në lidhje me një lloj turravrapit të të gjithë medias për ta kapur dhe për ta bërë publik një gjë, e cila nuk do të kishte hije as para 20 vjetësh dhe jo më tani. Unë mendoj se dëgjesat duhet t'i trajtojmë edhe në formën e llogaridhënies, jo thjesht vetëm një dëgjesë apo bashkëbisedim me kryetaren e AMA-s, por të jetë në formën e llogaridhënies. Dakord, ky rast kaloi, do të kërkohet ndjesa, por kjo çështje mund të ripërsëritet. A ka mekanizma që shtrëngojnë cilëndo media në Shqipëri? Unë po ju them se që të gjitha mediet nga mëngjesi në darkë këtë kanë pasur lajm.

Ajo çështje nuk është as dramë dhe as tragjedi, por është jeta e një vajze, e cila e ka zgjedhur vetë se si ta bëjë. Tragjedia dhe drama vijnë në kohën kur i gjithë ky presion ushtrohet nga të tjerët ndaj vajzës dhe ndaj familjes së saj: të ëmës, të atit, vëllait. Nuk di çfarë t'ju them, sepse nuk kam fjalë që ta përshkruaj.

Unë besoj se duhen gjetur mekanizmat shtrëngues, edhe me kryetaren e AMA-s dhe me cilindo që do të jetë i pranishëm, të flitet me gjuhën e kërkesës së llogarisë dhe të mekanizmave që duhet të ngrihen kundër atyre që abuzojnë me këtë çështje. U bë dëgjesa me kryetaren e AMA-s dhe kjo punë përfundoi; largqoftë të ndodhë një rast tjetër nesër, do të jetë prapë e njëjta histori. Unë mendoj se duhet të ndërmerret një nismë, pra, të shërbejë ky rast konkret, fatkeqësisht për ata, dhe të vihen binarët e moralitetit, sepse është turp i madh. Kemi fikur

televizorët, sot familjet shqiptare nuk shohin më televizor, sepse nuk kanë çfarë të shohin. Më mirë të shohin telenovela sesa atë, sepse është më shumë telenovelë kjo gjë që u dha sesa telenovelat që jepen.

Unë kërkoj që ky rast të bëhet nismë për ta konceptuar gjënë shumë më saktë sesa mund të jetë sot. Është hata, ndaj të njëjtin mendim me ju, sepse ka qenë shqetësues për të gjithë.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Ndreca!

Kjo është pikërisht ajo që duhet bërë, pra nëse ligji nuk i ndihmon dot, atëherë çfarë shtesash duhen, t'i sjellin dhe ne t'i bëjmë, sepse kështu bëhen gjërat në momentin dhe kohën e duhur dhe jo duke i lënë pas dore. Ideja është që ne t'u kërkojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë se çfarë duhet të bëjmë për ta përmirësuar këtë gjë.

Faleminderit!

Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – I bashkohem totalisht dhe plotësisht mendimit të zotit Ndreca. Pikërisht ky duhet të jetë fokusi ynë, jo thjesht gjykimi mbi atë që ka ndodhur, sepse aty është bërë dëmi, është cenuar dinjiteti njerëzor dhe gjithçka tjetër, por duhet të kemi në fokus që ngjarjeve të tilla, që prekin dinjitetin njerëzor, të cilat mund të ndodhin si me gratë, fëmijët apo me shtresa të tjera të marginalizuara të shoqërisë, t'u japim një rregullim ligjor dhe të kemi mundësinë që të mos përhapen brenda 24 orëve, duke u bërë virale dhe, më pas, reagimet e institucioneve të jenë, pasi gjërat të jenë bërë.

Sot, po të hyjmë, unë ia kam kërkuar kryetarit të AKEP-it, i cili nuk është institucion në vartësi të komisionit tonë, por është i lidhur me të, në *Youtube* ende e gjejmë videon e publikuar, pasi aty e hedhin individë dhe jo media. Unë mendoj se duhet ndërhyrja e një institucioni si AKEP-i, që është institucion përgjegjës për ta bllokuar, por ata nuk reagojnë në kohë, sepse nuk e kanë në prioritet e tyre, por merren me gjëra që i kanë prioritet. Unë këtë çështje e kam ngritur edhe në seancën plenare, kur AKEP-i ka raportuar dhe më vjen keq që ende është në këtë mënyrë.

Ne nuk duhet ta lëmë këtë në vullnetin e një punonjësi atje, i cili e sheh apo nuk e sheh, reagon apo nuk reagon në kohë, sepse duke vendosur masa të tilla ligjore, edhe për ato që janë institucione përgjegjëse, por edhe për ata që i publikojnë, mediat në shumicën e rasteve dhe jo thjesht individët, duhet të bëjmë diçka të mirë në lidhje me atë që mund të ndodhë në të ardhmen,

por edhe si një mënyrë faljeje si shoqëri për atë që ndodhi në këtë rast, një reagim i përbashkët i politikës. Mua më vjen mirë që e kemi gjetur këtë lloj konsensusi nga të dyja anët e politikës.

Faleminderit!

Flutura Aça – Faleminderit, zonja Zhupa!

Po, zoti Ajazi.

Besion Ajazi – Faleminderit, kryetare!

Besoj se nuk ka asnjë njëri në Shqipëri që të mos jetë sensibilizuar për këtë rast, patjetër që edhe ne, si ligjvënës, aq më shumë që jemi anëtarë të Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, ku janë bërë bashkë kolegët e të gjithë krahëve.

Unë dua ta ndaj në dy momente diskutimin tim të shkurtër në lidhje me këtë ngjarje. Sigurisht, ky është rasti që ne duhet ta mbështesim AMA-n. Pse e them këtë? E them këtë, pasi para pak javësh kishim në seancë dëgjimore për raportin vjetor drejtuesit e AMA-s, të cilët e ngritën shqetësimin e tyre në lidhje me ligjin e çalë, mbi të cilin ata funksionojnë. Ky nuk është një ligj i plotë, është ligj i viteve të kaluara, që nuk parashikon zhvillimin e vrullshëm që ka marrë media kohët e fundit. Pra, nuk parashikon portalet, rrjetet sociale dhe asgjë tjetër, përveç transmetuesve tradicionalë radio dhe televizion.

Me aq sa unë kam dijeni, Autoriteti i Medieve Audiovizive e ka bërë reagimin lidhur me ngjarjen, duke e dënuar ashpër atë, madje, me aq sa e lejon ligji, u ka kërkuar mediave, ose në gjuhën e ligjit, OSHMA-ve që t'i zhdukin ose t'i fshijnë të gjitha pamjet që ata kanë në redaksitë e tyre dhe të mos i transmetojnë, duke ruajtur kështu edhe një pikë tjetër të ligjit, i cili është moscenimi i privatësisë, i dinjitetit dhe i integritetit të çdo qytetari të Shqipërisë.

Në këto kushte unë edhe një herë vë theksin pikërisht në faktin se ka ardhur momenti që ne, si ligjvënës, ta mbështesim këtë institucion, i vetmi kontrollues mbi median, për ta bërë të fuqishëm dhe që nesër ne të kemi, ashtu siç e thotë edhe kolegu Ndreca, edhe ligjin, por edhe argumentin për t'i kërkuar llogari këtij institucioni. Sot me këtë ligj të cunguar dhe të çalë mbi të cilin funksionon AMA, ne nuk kemi se çfarë t'u kërkojmë.

Faleminderit!

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Ajazi!

Po, zonja Zake.

Enslemvera Zake – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju falënderoj për shqetësimin që ngritët dhe solidaritetin e të gjithë anëtarëve të komisionit!

Jam plotësisht dakord jo vetëm për takimin me drejtuesit e AMA-s dhe të AKEP-it për të kuptuar më mirë si funksionojnë, cilat janë hapësirat ligjore që duhen përmirësuar dhe ky është pikërisht momenti që ne duhet të vendosim për t'u bërë të gjithë bashkë, për të bërë ndryshimet ligjore, të cilat do na ndihmojnë jo vetëm ne, por gjithë shoqërinë. Ajo vajza, e cila ishte fatkeqe në këtë rast, përveçse ishte viktimë e dhunës fizike nga të ashtuquajturit familjarë, vazhdon të dhunohet për ditë psikologjikisht nëpër rrjetet sociale. AMA dhe AKEP-i vërtet i kanë marrë masat, por çfarë mund t'i bëjmë *Whatsapp*-it, ku një individ e transmeton këtë video te një tjetër apo *Youtub*-it? Janë pikërisht këto institucione që ne duhet të na hedhin dritë se ku duhet t'i bëjmë përmirësimet ligjore. Ne patjetër si anëtarë komisioni jemi të gjithë të gatshëm për të qenë prezent dhe për të marrë nismat e duhura për ndryshimet ligjore.

Kam edhe diçka lidhur me agjendën e javës tjetër sa i takon projektligjit të propozuar nga zonja Zhupa, si dhe për projektvendimin për ndryshimin e nivelit të pagave të Akademisë së Shkencave. Për shkak të angazhimeve të disa anëtarëve të komisionit, ndër ta edhe unë jam pjesë e Komisionit të Ekonomisë, kështu që e kam të pamundur të jem ditën e hënë. Kërkoj konsensusin e anëtarëve të komisionit që t'i bëjmë të dyja mbledhjet në datën 14 qershor, ditën e martë, të dyja mbledhjet bashkë ose në orare të ndryshme, ose njërën mbledhje ditën e martë dhe tjetrën ditën e mërkurë.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Zake!

Po, zonja Tahiraj.

Desantila Tahiraj – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu siç e thanë edhe kolegët, ngjarja e fundit, e cila nuk është e vetmja për fatin e keq, që mediet paraqesin qoftë për dhunimin e fëmijëve, ku në shumicën e rasteve i kanë nxjerrë me initiale, emra apo figurë, pa dyshim kjo e fundit ishte një ndër rastet flagrante të dhunës që ushtrohet jo vetëm nga familja, por edhe nga të gjitha mediet elektronike, e cila është një formë dhune e papranueshme.

Sigurisht që është momenti për të ndërhyrë në ligj, jemi në kohën e duhur, për të bërë rregullimet e duhura për të mbrojtur qytetarët nga të gjitha format e dhunës, sidomos nga ato që

janë shumë makabre. Pse? Sepse është një dhunë e ekspozuar në një numër tejet të madh të banorëve, pra i tejkalon kufijtë e Shqipërisë. Këto janë fenomene që hasin jo vetëm qytetarët shqiptarë, por kudo ku shihet *Youtube* do ta kenë parë këtë rast tejet të rëndë të dhunës.

Sigurisht është e rëndësishme që të mos ta zgjasim në kohë, por të bëjmë takimin e duhur me AMA-n dhe të fillojë të rishihet ligji për të bërë ndërhyrjet e duhura.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Tahiraj!

Ne e lamë paraprakisht në parim që nesër të organizojmë takimin.

Sa i takon kalendarit, besoj se ramë në konsensus se si do të operojmë, pasnesër kemi 2 mbledhje njëra pas tjetrës. Edhe sa i takon javës së ardhshme do të përpiqemi t'i bëjmë në një ditë, të martën apo të mërkurën, në mënyrë që ta ezaurojmë të gjithë kalendarin, të paktën deri ditën që do kemi mbledhje.

A jeni dakord me ndryshimet në kalendar? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Mbledhjen e kemi ditën e mërkurë në orën 10:00, por do ta merrni njoftimin zyrtarisht, në mënyrë që t'i konsumojmë të dyja.

A ka ndonjë gjë tjetër?

Faleminderit!

Shihemi ditën e mërkurë.

MBYLLET MBLEDHJA